

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00 и 44/02) и член 30 од Законот за основно образование Службен весник на РСМ, бр. 161 од 5.8.2019 година, министерот за образование и наука донесе наставна програма по Албански јазик за IX (деветто) одделение на деветгодишното основно образование, избран предмет за учениците од другите заедници.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



PROGRAMI MËSIMOR

**GJUHË SHQIPE (LËNDË ZGJEDHORE)
PËR KLASËN IX TË ARSIMIT FILLOR NËNTËVJEÇAR
PËR NXËNËSIT E BASHKËSIVE TË TJERA**

Shkup, 2019

Emri i lëndës	Gjuhë shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera
Statusi i programit mësimor	Lëndë zgjedhore
Klasa	IX
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	2 orë në javë /72 orë në vit
Qëllimet e programit mësimor	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përforcojë njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara më parë dhe të përvetësojë njohuri dhe shkathtësi të reja të komunikimit; - të lexojë dhe të kuptojë përmbajtjet letrare dhe jolettrare si dhe të aftësohet të bëjë interpretimin e tyre; - të motivohet të lexojë lektura (vepra të përshtatshme për nivelin e tij gjuhësor) dhe të bëjë analizë të pathelluar të tyre; - të përjetojë artistikisht krijimet e zgjedhura letrare-artistike; - të aftësohet të bashkëbisedojë, të rrëfejë ngjarjet, të ritregojë përmbajtjen e tekstit, të pyesë dhe të përgjigjet në pyetje; - të zhvillojë imagjinatën, vetëbesimin dhe të nxitet të shkruajë tekste të zgjedhura; - të aftësohet për të zhvilluar një diskutim, për të shkruar lutje, kërkesë, letër, urim, falënderim, ftesë e autobiografi; - të përvetësojë disa rregulla themelore të sintaksës së shqipes, të drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit; - të përmirësojë shkathtësinë e përkthimit nga gjuha e vet amtare në shqip e anasjelltas; - të përvetësojë njohuri të duhura për gjuhën, letërsinë dhe qytetërimin shqiptar në përgjithësi; - të nxitet bashkëpunimi, mirëkuptimi, shoqërimi i nxënësve, respektimi i gjuhëve dhe i kulturave të ndryshme.
Fusha programore (njësitë modulare) si pjesë përbërëse të programit mësimor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lexim letrar; 2. Gjuhë; 3. Kulturë gjuhe.

Kushtet hapësinore dhe materiale-teknike	Mësimi realizohet në mësonjëtoare ose në kabinet, ndërsa në raste të veçanta shoqërohet edhe me aktivitete përcjellëse që e zëvendësojnë vendin e mbajtjes së mësimin (institucionet e kulturës, institucionet shkencore, biblioteka, kinoteka, medioteka etj.).
Normativi për kuadrin arsimor	Lëndën Gjuhë shqipe në arsimin fillor mund ta realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer: Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.

Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
1. LEXIM LETRAR			
- të interpretojë dhe analizojë tekste letrare në prozë të shkëputura nga libri i leximit, revistat për fëmijë dhe nga burimet e tjera të përshtatshme;	Tekste letrare në prozë (lexim, interpretim, analizë tekstesh letrare për fëmijë)	- Ushtrime për lexim, interpretim dhe analizë tekstesh letrare për fëmijë. - Nxënësit mund të punojnë në grupe; formulojnë idetë e tyre dhe i shënojnë në fletore...; zgjedhin formulimet më të mira për t'i prezantuar në nivel të grupeve... Metodat: metoda e punës individuale, në grupe, metoda e analizës, e interpretimit, metoda ndërvepruese (interaktive), metoda audiovizuale etj.	Mund të lexojë, të kuptojë, di të interpretojë dhe analizojë tekste letrare në prozë për fëmijë.

- të dëgjojë, kuptojë, shijojë e recitojë poezi lirike shqipe;	Poezi	- Do të lexojnë, shijojnë e recitojnë poezi lirike. - Të dëgjojnë recitime poezish të shkurtra nga aktorë të njohur shqiptarë (që mund të gjenden edhe në internet).	Di të lexojë, mund të kuptojë e të recitojë poezi lirike shqipe.
- të lexojë, të kuptojë tekste dramatike dhe të bëjë dramatizimin e fragmenteve të lehta të përzgjedhura;	Tekste dramatike	- Vënia në skenë e një pjese (fragmenti) të shkëputur nga një vepër dramatike.	Lexon rrjedhshëm, kupton dhe luan një rol në dramë të shkurtër, të lehtë, me pak tekst.
- të aftësohet të komentojë (me ndihmën e arsimtarit) 2-3 lektyra që paraprakisht nxënësi i ka lexuar.	Lektyra	- Për ta arritur këtë nevojitet punë serioze dhe përzgjedhje e kujdesshme e lektyrave, gjuha e të cilave duhet të jetë e përshtatshme për nivelin e zotërimit të shqipes nga nxënësit.	Ka lexuar 2-3 lektyra për fëmijë dhe bën interpretim sipërfaqësor të tyre.
Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
2. GJUHË			
- të fitojë njohuri se shqipja i përket familjes së gjuhëve indoevropiane dhe gjuhëve ballkanike; - do të ketë njohuri edhe për disa veçori të përbashkëta të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike;	Shqipja – gjuhë indoevropiane dhe ballkanike	- Lexim e analizë teksti për karakterin indoevropian të shqipes. - Lexim e analizë teksti për gjuhët ballkanike, përfshirë edhe shqipen. Metodat: frontale, ndërvepruese (interaktive), e krahasimit, e analizës, e sintezës etj.	Do të ketë njohuri se cilës familje gjuhësore i përket shqipja. Do të dijë disa veçori të përbashkëta të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike (përfshirë edhe gjuhën e nxënësit).

- të njihet me dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet gjuhës standarde (letrare) dhe dialekteve të shqipes;	Gjuha standarde dhe dialektet	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për të hetuar dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet formës standarde dhe dialektore të shqipes.	Di se shqipja ka një formë standarde dhe dy dialekte. Dallon ligjërimin standard (letrar) të shqipes nga të folmet dialektore.
- të dallojë dhe të përdorë drejt fjalët e thjeshta (të parme) dhe të prejardhura (me parashtesa, prapashtesa, parashtesa+prapashtesa) dhe të përbëra (kompozita, fjalë të përngjitura);	Fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra	- Ushtrime për të identifikuar dhe përdorur drejt fjalët e thjeshta e jo të thjeshta.	Dallon dhe përdor drejt fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra.
- t'i identifikojë, t'i shkruajë dhe t'i shqiptojë drejt fjalitë e thjeshta;	Fjalja e thjeshtë	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për përdorimin e drejtë të fjalive të thjeshta.	Dallon dhe shprehet drejt me fjali të thjeshta.
- të identifikojë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë (kryefjalën dhe kallëzuesin) si dhe të jetë në gjendje t'i përdorë drejt në ligjërim;	Kryefjala dhe kallëzuesi	- Ushtrime për të identifikuar kryefjalën dhe kallëzuesin si dhe për përdorimin e drejtë të tyre në ligjërim.	Identifikon kryefjalën dhe kallëzuesin si dhe i përdor drejt në ligjërim.
- të ketë njohuri për fjalitë pohore dhe mohore si dhe t'i përdorë ato siç duhet;	Fjalitë pohore dhe mohore	- Ushtrime (me shkrim e me gojë) për përdorimin e drejtë të fjalive pohore dhe mohore.	Përdor siç duhet fjalitë pohore dhe mohore.
- të marrë njohuritë e nevojshme për fjalitë pyetëse dhe nxitëse si dhe t'i përdorë drejt ato;	Fjalitë pyetëse dhe nxitëse	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalive pyetëse dhe nxitëse.	Di të përdorë drejt fjalitë pyetëse dhe fjalitë nxitëse.
- të përdorë drejt sipas funksionit fjalët në fjali (emrin, përemrin, numërorin, foljen, mbiemrin etj.);	Funksionet e fjalëve në fjali	- Ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalëve në fjali sipas funksionit (të emrit, përemrit, numërorit, foljes, mbiemrit etj.).	Përdor drejt fjalët në fjali sipas funksionit (të emrit, përemrit, numërorit, foljes, mbiemrit etj.).

- të përdorë drejt fjalitë e përbëra (të zgjeruara) në komunikim;	Fjalia e përbërë	- Ushtrime për dallimin dhe përdorimin e drejtë të fjalive të përbëra (të zgjeruara). - Ushtrime për të shndërruar fjalitë e thjeshta në fjali të përbëra. P.sh.: <i>Genti lexon.</i> <i>Genti lexon shumë.</i> <i>Genti lexon shumë libra.</i>	Përdor drejt fjalitë e përbëra (të zgjeruara) në komunikimin me shkrim e me gojë.
- formën e folur të ligjërit ta shndërrojë në formë të shkruar;	Diktim	- Diktime tekstesh të shkurtra për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit (identifikimi i përbërjes tingullore të fjalëve dhe shënimit të tyre me shkronja, përdorimi i shenjave të pikësimit etj.).	Shkruan mirë diktimin.
- të përkthejë tekste nga shqipja në gjuhën e vet amtare dhe anasjelltas.	Përkthim	- Ushtrime përkthimi tekstesh nga shqipja në gjuhën amtare të nxënësit dhe anasjelltas.	Di të përkthejë tekste nga shqipja në gjuhën e vet amtare dhe anasjelltas.

Sqarim:

Përmbajtjet mësimore të fushës programore *Gjuhë* realizohen nëpërmjet përmbajtjeve të njësive modulare të tërësive tematike lexim letrar dhe kulturë gjuhe, që do të thotë se ato janë integruar në njësitë komunikative për të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Përmbajtjet mësimore të *Gjuhës* në program janë shënuar si tema më vete, por realizimi i tyre nuk nënkupton interpretim metagjuhësor, d.m.th. shpjegim ose përkufizim gjuhësor. Aftësitë gjuhësore të përfshira në këto përmbajtje mësimore nxënësit i përvetësojnë në mënyrë pragmatike – nëpërmjet të dëgjuarit, të vërejturit, shqiptimit, kopjimit, përsëritjes, të treguarit, të biseduarit etj.

Rezultatet e mësimnxënies Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Standardet e vlerësimit Nxënësi/nxënësja mund të:
3. KULTURË GJUHE			
- të shkruajë në shqip një lutje a kërkesë;	Si të shkruajmë një lutje a kërkesë	- Detyrë për të shkruar në shqip një lutje a kërkesë (sipas modelit).	Di të shkruajë në shqip një lutje a kërkesë (sipas modelit).
- të shkruajë në shqip një letër; - të njoftohet si udhëton letra nga dërguesi te pranuesi nëpërmjet postës;	Si të shkruajmë një letër	- Nxënësve u jepet për detyrë të shkruajnë një letër. - Parapëlqehet të bëhet një vizitë mësimore në postën më të afërt dhe të kërkohet nga një njeri kompetent t'u shpjegojë nxënësve (në shqip) për punën e postës.	Di të shkruajë në shqip një letër.
- të shkruajë në shqip një urim për ditëlindje, për festa etj., apo një falënderim;	Si të shkruajmë një urim, falënderim	- Nxënësve u jepet për detyrë të shkruajnë një urim e një falënderim.	Shkruan në shqip një urim e një falënderim.
- të aftësohet të shkruajë në shqip një ftesë për ditëlindje, festë, veprimtari ekologjike, humanitare etj.;	Si të shkruajmë një ftesë	- U jepet për detyrë të shkruajnë një ftesë në shqip.	Shkruan në shqip një ftesë.
- të shkruajë jetëshkrimin e vet në shqip;	Autobiografia	- Nxënësve u jepet për detyrë të shkruajnë jetëshkrimin e tyre në shqip.	Shkruan jetëshkrimin (autobiografinë) e vet në shqip.
- të njoftohet me rolin e mjeteve të informimit për përhapjen e informatave, të dijës, të artit, të muzikës, të kulturës së gjuhës, të kulturës së përgjithshme etj.;	Mediet e shkruara dhe ato elektronike	- Parapëlqehet që mësimdhënësi së bashku me nxënësit të bëjnë një vizitë mësimore në ndonjë prej televizioneve apo shtëpive botuese gazetareske të qytetit.	Njeh rolin e mjeteve të informimit për përhapjen e informatave, të dijës, të artit, të muzikës, të kulturës së gjuhës, të kulturës së përgjithshme etj.

- të njoftohet si shkruhen gazetat, revistat si dhe me procesin e punës në radio e televizion;	Gazeta, revista, radioja dhe televizioni	- Është e udhës të ftohet në orë të mësimit një njeri profesionist që t'i njoftojë nxënësit (në shqip) me procesin e punës. Njeriu kompetent mund t'u përgjigjet pyetjeve të nxënësve lidhur me punën profesionale.	Është i njoftuar se si shkruhen gazetat, revistat si dhe me procesin e punës në radio e televizion.
- të njoftohet me rolin e bibliotekës për arsimin dhe shkencën si dhe të motivohet të lexojë në bibliotekë, të ngjallet dëshira për të lexuar libra dhe për të pasur një bibliotekë në shtëpi;	Biblioteka	- Kërkoni nga bibliotekari (i shkollës ose i qytetit) që t'ju njoftojë (në shqip) me organizimin e punës në bibliotekë.	Di rolin e e bibliotekës për arsimin dhe shkencën. Fillon të krijojë një bibliotekë në shtëpi (nëse nuk e ka pasur) ose e pasuron bibliotekën që tani më e ka në shtëpi.
- të njoftohet me mundësitë dhe nevojën e shfrytëzimit të internetit për qëllime të mira (arsimore, shkencore, teknike, shëndetësore, kulturore etj.).	Interneti	- Nxënësve mund t'u jepet për detyrë të kërkojnë në internet që të gjejnë materiale mësimore për gjuhën shqipe.	Di të përdorë internetin për qëllime të mira (arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, sport, muzikë etj.).
- të aftësohet dhe të fitojë shprehi që të komunikojë nëpërmjet e-mailit, duke respektuar rregullat themelore të përdorimit të tij.	Si të komunikojmë me e-mail	- Nga nxënësit kërkohet që të hapin e-maillet personale dhe të fillojnë të komunikojnë së pari ndërmjet tyre e sipas nevojës edhe me të tjerët.	Di të komunikojë nëpërmjet e-mailit dhe respekton rregullat themelore të përdorimit të tij.

Vlerësimi i arritjes së nxënësve	<p>Vlerësimi i rezultateve është i detyrueshëm dhe bëhet sipas normave ligjore. Përparimi dhe vlerësimi i nxënësve ndiqet rregullisht dhe kryhet në vazhdimësi gjatë orëve mësimore, me qëllim që vlerësimi t'u shërbejë nxënësve për të ditur gjendjen reale të diturive të veta si dhe do të stimulohen për përmirësimin dhe thellimin e përhershëm të tyre. Në përputhje me natyrën e programit të lëndës së Gjuhës shqipe për nxënësit e bashkësive të tjera, vlerësimi mund të bëhet nëpërmjet formës me gojë dhe me shkrim ose me ndonjë formë tjetër.</p> <p>Instrumenti gojor i vlerësimit përfshin përgjigjet që jep nxënësi në pyetjet e bëra, parashtrimin e pyetjeve (për nxënës) dhe zhvillimin e bashkëbisedimeve të shkurtra.</p> <p>Instrumenti shkrimor parapëlqen ushtrime për nxënien dhe përvetësimin e alfabetit të shqipes (shkronjave të shtypit dhe të dorës).</p> <p>Vlerësimi bëhet në një teme të caktuar, gjatë tremujorshit, gjysmëvjetorit dhe në fund të vitit shkollor.</p> <p>Për nxënësit që nuk i përvetësojnë në nivelin e mjaftueshëm njohuritë, detyrimisht organizohet mësim plotësues.</p> <p>Nxënësi vlerësohet me notë numerike.</p>
Literatura dhe burime të tjera	<p>Libri shkollor i miratuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës (libër me vizatime, doracak mësimdhënësi për zbatimin e aktiviteteve programore, material për lexim dhe shkrim fillestar të shkronjave të shtypit dhe të dorës), tabelë interaktive, Internet (softuera arsimorë, ueb-faqe), aplikacione mobile etj.</p>
Institucioni/ bartësi i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit (BZhA)
Потпис и датум на донесување на наставната програма	<p>бр. 12-11216/5 28.10.2019 година</p> <p style="text-align: right;">МИНИСТЕР, ср. Dr. Arbër Ademi</p>
Датум на ревизија	